



UNIVERSITETIT "FAN S. NOLI" KORÇË  
FAKULTETI I EUKIMIT DHE FILOGJISË  
DEPARTAMENTI I EDUKIMIT



**WORKSHOP**  
**KOMPETENCAT NË DISIPLINAT BAZË TË**  
**EDUKIMIT**

**KORÇË, 26 PRILL 2019**

## THIRRJE PËR PJESËMARRJE NË WORKSHOP

DEPARTAMENTI I EDUKIMIT NË FAKULTETIN E EDUKIMIT DHE FILOLOGJISË NË UNIVERSITETIN E KORÇËS, NË BASHKËPUNIM ME DEPARTAMENTIN E GJUHËS DHE TË LETËRSISË, DEPARTAMENTIN E GJUHËVE TË HUAJA, DEPARTAMENTIN E HISTORI - GJEOGRAFISË, DEPARTAMENTIN E MATEMATIKËS DHE FIZIKËS PRANË KËTUI UNIVERSITETI, ORGANIZOJNË WORKSHOPIN ME TEMË:

### KOMPETENCAT NË DISIPLINAT BAZË TË EDUKIMIT

#### QËLLIMI I WORKSHOPIT:

KY WORKSHOP ORGANIZOHET ME SYNIMIN KRYESOR QË TË BËJË BASHKË MËSIMDHËNËS TË TË GJITHA CIKLEVE TË EDUKIMIT NË RAJONIN E KORÇËS DHE MË GJERË, ME QËLLIM OFRIMIN E PRAKTIKAVE TË MIRA TË TYRE NË ZHVILLIMIN E FUSHAVE BAZË TË DIJES NË MËSIMDHËNIE.

Me ndryshimet që ndodhin në shoqëri, shfaqen nevoja të reja, marrëdhënie të reja në shoqëri dhe në tregun e punës, risi teknologjike, aspirata të reja njerëzore, strategji të reja për zhvillim etj. Këtyre ndryshimeve arsimit duhet t'u përgjigjet me ritme të shpejta, me zhvillime të brendshme sasiore e cilësore, për të mundësuar njohuri të reja, shkathtësi, vlera dhe qëndrime të përshtatshme, sistematike, koherente dhe në zhvillim të përhershëm. Në këto kushte, nevoja për ndryshime kurrikulare që synojnë kompetencat, rishfaqet gjithnjë e më shpesh si domosdoshmëri në fushën e politikave arsimore dhe praktikën shkollore.

Kompetencat në disiplinat bazë konsiderohen si shumë të rëndësishme në procesin e përgatitjes së mësuesve. Ato paraqesin bazën për zhvillimin e kurrikulave dhe plan-programeve mësimore, përdoren për të përcaktuar veprimtaritë mësimore dhe respektivisht, duhet të vlerësohet niveli i arritjes në tyre. Kompetencat shprehen nëpërmjet përdorimit të njohurive, shkathtësive, vlerave dhe qëndrimeve në trajtimin e plotë dhe të kuptueshëm të situatave të kontekstit dhe konkretizohen në rezultatet e pritshme të të nxënit, në përmbajtjet mësimore dhe në kulturën e përditshme të individit.

Sot lind si nevojë e ngutshme bashkëpunimi dhe ndarja e përvojave universitare dhe atyre parauniversitare, për të zgjidhur problemin e dallimeve mes kurrikulave përmes afrimit dhe përvojave të suksesshme, duke shmangur problemet me përgatitjen, përshtatjen dhe cilësinë e studentëve të fakulteteve të mësuesisë.



Centered on  
the student

Focused on  
mastery of  
competencies

Based on  
learning  
outcomes

Tematikat kryesore të studimit për përgatitjen e punimeve:

1. Gjuhët dhe komunikimi
2. Matematika
3. Shkencat e natyrës
4. Shoqëria dhe mjedisi
5. Artet
6. Edukim fizik, sporte dhe shëndeti
7. Teknologjia dhe TIK-u

Data me rëndësi:

-  **DËRGIMI I ABSTRAKTEVE: 15 PRILL 2019**
-  **PRANIMI I ABSTRAKTEVE 20 PRILL 2019**
-  **DËRGIMI I PROGRAMIT TË PLOTË: 23 PRILL 2019**

**DATA E ZHVILLIMIT TË WORKSHOPIT: 26 PRILL 2019**

Vendi i Workshopit:

Workshopi do të mbahet në Universitetin “Fan S. Noli” Korçë, në Fakultetin e Edukimit dhe Filologjisë

Gjuha zyrtare e workshopit: **Gjuha shqipe**

Informacione të rëndësishme:

Abstraktet duhet të jenë deri në 250 fjalë. Në të duhet të përfshihen **3-5 fjalë kyçe** që përshkruajnë më së miri fushën e paraqitjes së punimit. Shkrimi i përdorur e përdorur duhet të jetë: **Format A4, Times New Roman 12 pt** me margjina **1cm**, hapësirë **1,5** dhe shtrirja e shkrimit duhet të jetë: **Justified**

Abstrakti duhet të përfshijë: **Titullin, autori(ët), institucionin, adresa e e-mail-it (Bold)**  
Propozimi i punimit duhet të jetë origjinal dhe i pa publikuar më parë.

Abstrakti duhet të dorëzohet në rrugë elektronike në adresën:

[workshopedukimi@yahoo.com](mailto:workshopedukimi@yahoo.com)

Konfirmimi për pranimin e abstraktit do të dërgohet në rrugë elektronike në adresën personale të aplikantit.



Të gjithë punimet e pranuar në workshop do të përmbliidhen në “**Udhërrëfyes për mësuesin me kompetenca të Disiplinave Bazë të Edukimit**” që do të jetë ndihmesë për stafin akademik dhe studentët, që të mund të përdoret si model studimi. Botimi do të jetë i publikuar me ISBN.

Abstraktet do të pranohen nëse i plotësojnë kushtet dhe kërkesat brenda fushave tematike dhe kritereve të përgatitjes së abstraktit.

Pjesëmarrësit e workshopit do të pajisen me certifikatën e pjesëmarrjes.

